



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. _____ prot

Maliq më 24 / 04 / 2024

RELACION

Për

“Disa shtesa në Vendimin nr.136, datë 26.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë maliq,penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2024”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 dt 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 64 “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë” pika c, si dhe nenit 54 “Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit Bashkiak”, pika f, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. 9632 dt 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 si dhe Vendimin nr. 136 datë 26.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Maliq, “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2024”,

Duke u bazuar në dëgjuesat publike të kryera përpara miratimit të Paketës Fiskale, nga ana e Institucionit janë parashikuar tarifat e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit për kantieret e ndërtimit të objekteve individuale dhe kantieret e ndërtimit të objekteve bujqësore/ industriale, deri në përfundimin e lejes së ndërtimit. Pranë institucionit Bashkia Maliq është paraqitur kërkesa për pajisje me leje ndërtimi për objekt të kombinuar banimi dhe magazinë bujqësore. Duke qënë se në Paketën Fiskale të miratuar mungon parashikimi për ndërtime të këtij lloji, pra të kombinuar banimi dhe shërbime, kërkohet nga ana e Këshillit të Bashkisë të miratojë tarifat e reja pastrim, ndriçim dhe gjelbërim për kategorinë e mësipërme si më poshtë:

1. Të shtohet tek Tarifat vendore pika 1.II.2.d Ndërtim objekte të kombinuara – 25 000 lekë/ kantieri
2. Të shtohet tek Tarifat vendore pika pika 2.II.2.d Ndërtim objekte të kombinuara – 3 000 lekë/ kantieri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Të shtohet tek Tarifat vendore pika pika 2.II.2.d Ndërtim objekte të kombinuara – 3 000 lekë/
kantieri

Jurist : J.Thomo

Përgjegjës sektori administrimi i leja: R. Spaho

Drejtore të Ardhurave: J.Grabocka

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

